




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

Furnizimi me serra

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës, të aplikojnë për furnizim me serra:

- Ngritja e serrës, në sipërfaqe prej 0.02ha ,
- Ngritja e serrës, në sipërfaqe prej 0.05 ha,
- Ngritja e serrës, në sipërfaqe prej 0.10ha.

Kriteret e përgjithshme:

1. Aplikuesi duhet të ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banor rezident i saj;
2. Fermerët të cilët planifikojnë ngritjen e serrës, duhet të posedojnë sipërfaqe sipas kategorive në vazhdim:
 - Për kategorinë prej 0.02 ha , kërkohet sipërfaqe prej 0.03 ha,
 - Për kategorinë prej 0.05ha , kërkohet sipërfaqe prej 0.06ha ,
 - Për kategorinë prej 0.10 ha , kërkohet sipërfaqe prej 0.12 ha – kjo për arsye të infrastrukturës përcjellëse përreth serrës;
3. Fermerët të cilët planifikojnë ngritjen e serrës sipas kategorisë I, në sipërfaqe prej 0.02 ha, për shkak të madhësisë së serrës, parashihet serra e tipit “Tunel”, kurse për kategorinë II, në sipërfaqe prej 0.05 ha, si dhe për kategorinë III prej 0.10 ha, serra e tipit “Bllok”;
4. Për secilën kategori fermeri duhet të participojë me 20% të vlerës së përgjithshme të serrës;
5. Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
6. Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka më qira, duhet të kenë marrëveshje të nënshkruar nga palët, në kohëzgjatje prej tre (3) vitesh;
7. Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare të cilët kanë përfituar serrë nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën, në tri (3) vitet e fundit;
8. Përfituesit nuk kanë të drejtë që të shesin apo të tjetërsojnë serrën në tre (3) vitet pasuese;

9. Kushtet specifike në mes të përfituesit dhe Komunës së Prishtinës, do të përcaktohen përmes kontratës së nënshkruar në mes palëve, e cila përfshinë përveç tjerash, mënyrën e pagesës, procedurat e implementimit, si edhe përgjegjësitë dhe obligimet në mes të palëve.

Kriteret specifike:

1. Në kushte të barabarta, përparësi kanë zonat me prioritet të identifikuar nga Komuna;
2. Njohuritë elementare në fushën përkatëse;
3. Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
4. Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
5. Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
6. Familja (fermerët) pa asnjë anëtar të punësuar(përparësi);
7. Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
8. Infrastruktura përcjellëse (burimi i ujit, sistemi ujitjes);
9. Largësia e fermës nga vendbanimi;
10. Konfiguracioni i terrenit.

Dokumentacioni:

1. Numri identifikues i fermerit (NIF);
2. Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
3. Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, jo më e vjetër se një vit;
4. Marrëveshja në mes palëve – nëse toka është me qira për tri (3) vjet;
5. Kopja e planit, jo më e vjetër se një vit;
6. Vërtetimi i tatimit në pronë për vitin 2020;
7. Dëshmi nga institucioni përkatës rreth statusit të punësimit (nëse posedon).

Data e aplikimit, prej 05.11.2021 deri më 19.11.2021